



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR SHYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË KOMBËTARE KONSERVATORE ALBANIA, PËR  
DORËZIMIN E DOKUMENTAVE PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR KRYETAR  
BASHKIE DHE LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E  
BASHKISË PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30  
QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Kombëtare Konservatore Albania" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**



**Nr. 592 i Vendimit**

**Data 19.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Partia "Kombëtare Konservatore Albania" me vendimin e KQZ-së nr. 40, datë 13.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

Z. Kujtim Gjuzi me cilësinë e kryetarit të partisë "Kombëtare Konservatore Albania", ka depozituar në KQZ më datë 18.05.2019 dokumentacionin për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie në bashkitë: Gramsh dokumenacionin me nr. 3949 datë 18.05.2019, Vau Dejës dokumenacionin me nr. 3952 datë 18.05.2019, Shkodër dokumenacionin me nr. 3953 datë 18.05.2019, Tiranë dokumenacionin me nr. 3955 datë 18.05.2019, Pogradec dokumenacionin me nr. 3956 datë 18.05.2019, Durrës dokumenacionin me nr. 3957 datë 18.05.2019, Mirditë dokumenacionin me nr. 3960 datë 18.05.2019, Dibër dokumenacionin me nr. 3965 datë 18.05.2019, Memaliaj dokumenacionin me nr. 3967 datë 18.05.2019 si dhe listën shumëmemërore të kandidatëve për anëtar Këshilli në bashkitë: Tepelenë dokumenacionin me nr. 3946 datë 18.05.2019, Lezhë dokumenacionin me nr. 3947 datë 18.05.2019, Gramsh dokumenacionin me nr. 3948 datë 18.05.2019, Rrëshen dokumenacionin me nr. 3970 datë 18.05.2019, Vau Dejës dokumenacionin me nr. 3951 datë 18.05.2019, Tiranë dokumenacionin me nr. 3954 datë 18.05.2019, Pogradec dokumenacionin me nr. 3958 datë 18.05.2019, Durrës dokumenacionin me nr. 3959 datë 18.05.2019, Dibër dokumenacionin me nr. 3963 datë 18.05.2019, Skrapar dokumenacionin me nr. 3964 datë 18.05.2019, Devoll dokumenacionin me nr. 3969 datë 18.05.2019, Memaliaj dokumenacionin me nr. 3966 datë 18.05.2019, Krujë dokumenacionin me nr. 3968 datë 18.05.2019, Mirditë dokumenacionin me nr. 3970 datë 18.05.2019.

Në bazë të nenit 67, pika 1, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë parashikon se "Partia politike që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhje, depoziton në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

Bazuar në nenin 67, pika 1 dhe të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore, dokumentacioni i depozituar nga kryetari i partisë "Kombëtare Konservatore Albania" është jashtë afatit të përcaktuar.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga z. Kujtim Gjuzi kryetar i Partisë "Kombëtare Konservatore Albania" është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 72 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



**Nr. 592 i Vendimit**

**Data 19.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

## V E N D O S I:

1. Mospranimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 592 i Vendimit**

**Data 19.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për shyrtimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019